



RAPORTI VJETOR 2015 **Co-PLAN**



Raporti Vjetor Co-PLAN 2015

Adresa:

Co-PLAN, Rruga Bylis 12, Kashar, K.P. 2995, Tiranë - Shqipëri

www.co-plan.org | co-plan@co-plan.org

Përgatitur nga: Renisa Muka, Aida Ciro, Ingrid Xhafa

Redaktuar nga: Besiana Bregu, Aida Ciro

Viti i Publikimit: 2015

Përdorimi apo riprodhimi i një pjesë apo tërësisë së materialeve të shkruara dhe të fotografive në këtë raport, nuk mund të kryhet pa pëlqimin dhe dakordësimin paraprak të Co-PLAN.



I nderuar partner,

Me shumë kënaqësi ndajmë me ju zhvillimet më të rëndësishme të punës së Co-PLAN për vitin 2015, si dhe zhvillimet më të rëndësishme në fushat e zhvillimit urban dhe hapësinor, financave publike, dhe manaxhimit mjedisor.

Në përgjithësi, viti 2015 shënoi një vit të rëndësishëm zhvillimesh, veçanërisht për sa i përket risive në fushën e planifikimit të territorit, siç ishte fillimi i zbatimit të Reformës Administrative Territoriale, nisur me zgjedhjen e Qeverisë së re Vendore në Qershor të vitit 2015. Mbi bazën e punës analitike dhe ekspertizës ndër vite, hartuam platformën "Tirana për Qytetarët", si një kontribut për axhendat elektorale të kandidatëve në zgjedhje vendore të 2015-tës, që synonte të ushqente kontratën e kandidatit apo kryetarit të ardhshëm me qytetarët e tij, pa marrë përsipër të shteronte programe politike apo menaxheriale të qeverisjes vendore.

Momente të tjera të rëndësishme përgjatë vitit veçojmë: punën me 5 bashkitë pilote në vend për hartimin e strategjive të zhvillimit të territorit, në kuadër të hartimit të planeve të përgjishme vendore; lançimi i projektit LëvizAlbania, i cili synon forcimin e shoqërisë civile dhe individëve në nivel vendor, si agjentët kryesor të ndryshimit; procese me pjesëmarrje për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies sociale; hartimin e Platformës së Financave Vendore, e cila i jep mundësinë çdo të interesuari të njihet me pasqyrat financiare të bashkive, për arsye monitorimi, analizimi, studimi, etj. Jemi të lumtur, që së bashku me partnerët, publikuam Manualin Teknik të Planifikimit, si një udhërrëfyes i përditësuar në funksion të nevojave të bashkive dhe autoriteteve të tjera publike për realizimin e analizave hapësinore/territoriale në planifikimin vendor, dhe në lidhje me shumëllojshmërinë dhe zbatimin e instrumenteve të zhvillimit të tokës për financimin e infrastrukturave publike.

Gjej rastin t'ju falenderoj për kontributin dhe bashkëpunimin tuaj në përpjekjet e përbashkëta për të ndryshuar pozitivisht panoramën e zhvillimeve urbane në Shqipëri, si dhe ju ftoj të shfletoni këtë raport, pse jo për të stimuluar ide bashkëpunimi për vitet e ardhshme.

Dritan Shutina

Drejtor Ekzekutiv

Përmbajtja



Rreth Co-PLAN

Profili Organizativ i Co-PLAN

Bordi Drejtues

Stafi i Co-PLAN



Ngjarjet Kryesore 2015

1. Aktivitet lançues i Platformës “Financat Vendore”
2. Forcimi i Kapaciteteve të Qeverisjes Vendore - Dialog Kombëtar
3. Hartimit i Planeve të Përgjithshme Vendore në 5 Bashki - Konsultime dhe Dëgjesa Publike
4. Publikimi i Manualit Teknik “Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri
5. Aktivitet lançues i Projektit “LëvizAlbania”
6. Aktivitete në Rajon
 - Llogaridhënia Sociale dhe Angazhimi Qytetar - *Workshop* Rajonal (UPP II)
 - Zgjidhje Novatore për Qytete të Qendrueshme - Dialogu Kombëtar në Kroaci (UPP II)
 - Prezantimi Publik i Fondit të Artit dhe Kulturës për Ballkanin (BAC)
 - Aktiviteti dedikuar Hapësirës Publike - Dizajni i Komunitetit në Prishtinë
 - Konferenca Rajonale e Shoqërisë Civile në Beograd
 - Konferenca mbi Vlerësimin dhe Taksimin e Pronës për Qendrueshmëri Fiskale dhe Qeverisje Lokale të Përmirësuar
7. Bashkëpunime me Universitetin POLIS



Projekte 2015

1. Projekti për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore në Shqipëri (PLGP)
2. Platforma ENV.net në Ballkanin Perëndimor
3. Demokracia në Veprim: Aktivizmi Urban për Demokraci Qytetare
4. Vetëvlerësimi Financiar Vendor (MFSA) dhe Auditi Urban (UA)
5. Qëndrueshmëria Sociale dhe Angazhimi Qytetar nën UPP II
6. Monitorimi sistematik i gjëndjes financiare dhe Praktika e menaxhimit financiar në nivel vendor
7. Projekti Promovimi i Demokracisë Vendore – ‘LëvizAlbania’
8. TraSaCu (Traffic Safety Culture)
9. Hartimi i Planeve Operative të Zhvillimit Lokal (POZHL) për Njësitë e sapoformuara të Qeverisjes Vendore në Shqipëri
10. dldp II: (Komponenti i Mbetjeve të Ngurta) Zhvillimi i Skemave Ndër-vendore dhe Modeleve të Kompostimit, në zonën e Pukës dhe në zonën e Malësisë së Madhe

Rreth Co-PLAN



Njihuni me Co-PLAN

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit është një organizatë jofitimprurëse që kontribon në zhvillimin e qëndrueshëm, në qeverisjen e mirë urbane dhe rajonale, duke trajtuar çështjet kyçe mjedisore, zhvillimin e shoqërisë civile, si dhe duke ndikuar politika dhe promovimin e pjesëmarrjes së komunitetit që nga viti 1995. Në thelb të aktivitetit tonë është puna me njerëzit dhe institucionet, për të nxitur transformim të prekshëm social dhe ndryshime pozitive në terren, duke prodhuar njohuri promovuese për një manaxhim më të mirë të habitatit. Co-PLAN përmbush misionin e tij përmes aktiviteteve pilot dhe shërbimeve këshilluese, të cilat financohen nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përfshirjes së drejtpërdrejtë me komunitetet, njësitë e qeverisjes vendore dhe organizata të tjera joqeveritare në fushën e manaxhimit urban dhe rajonal, manaxhimit të mjedisit dhe financave komunale. Edhe pse ne jemi bazuar në Tiranë, Shqipëri, ne kemi zhvilluar një rrjet të gjerë projektsh në terren në nivel rajonal dhe kombëtar. Puna kërkimore dhe konsultative e Co-PLAN ndërton mbi katër fusha ekspertize: Zhvillimi Urban dhe Rajonal, Manaxhimi i Financave Publike, Manaxhimi i Mjedisit Urban dhe Punë Kërkimore, si një element i integruar në të gjitha fushat. Secila ekspertizë trajtohet nga ekiye të dedikuara.

Planifikimi Hapësinor dhe Manaxhimi i Tokës - Aspiratat, përfshirja dhe angazhimi i Co-PLAN në këtë fushë është zgjeruar dhe maturuar me kohën dhe pasqyrohet qartë në aktivitetet e shumta në shkallë (prsh. në lagje, qytet, rajon, ndër-rajon dhe nivele kombëtare) dhe në numrin e madh të aktorëve të përfshirë, si: komuniteti, qeveria Qëndrore dhe ajo Vendore, bizneset, donatorët dhe organizata të Shoqërisë Civile. Co-PLAN ka mbështetur qeveritë vendore, OJQ-të dhe grupet e biznesit në adresimin e problematikave të zhvillimit urban, nëpërmjet përgatitjes së strategjive të zhvillimit të qytetit, planeve rregulluese urbane, planeve të zhvillimit të lagjeve, si dhe dokumentave të tjera udhëzuese. Sot, Co-PLAN luan një rol të rëndësishëm në nivelet e politik-bërjes, i angazhuar në mënyrë aktive në rishikimin e ligjit “Për Planifikimin e Territorit”, ndërtimin e kapaciteteve për implementimin e drejtë të ligjit, trajnimin dhe asistimin e NJQV-ve në përgatitjen e Planeve Vendore të Zhvillimit.

Qeverisje Urbane dhe Rajonale - Financat përbëjnë një element të pandashëm të çdo procesi zhvillimi. Ndaj, Co-PLAN, prej vitesh ka promovuar rëndësinë e manaxhimit të financave bashkiake në zhvillimet urbane në Shqipëri. Deri tani, Co-PLAN ka punuar me qeveritë vendore për të përmirësuar praktikën e manaxhimit të financave vendore, nëpërmjet përgatitjes së programeve të investimeve kapitale, buxhetit vjetor me pjesëmarrje, analizave të kostove të partneritetit publik-privat, dhe përmisimin e vjeljes së taksave. Çështje të llogaridhënies sociale dhe transparencës përbëjnë një pjesë të rëndësishme të portofolit të projekteve të Co-PLAN, duke u fokusuar në rëndësinë e transparencës dhe hapjes së të dhënave në mënyrë që të përmirësohet performanca e qeverisjes në terma të matshme të llogaridhënies dhe transparencës.

Manaxhim Mjedisor Urban - Zhvillimi territorit, veçanërisht kur bëhet në mënyrë të shpejtë dhe informale ka pasoja të mëdha dhe të pakthyeshme për mjedisin. Si rrjedhojë, manaxhimi i mjedisit të qendrueshëm përbën një pjesë të rëndësishme të ekspertizës kryesore dhe projekt-portofolit të Co-PLAN. Fokusi në këtë fushë të veçantë ka qënë në përmisimin e efikasitetit dhe standardeve të shërbimeve të lidhurave me mjedisin (veçanërisht në manaxhimin e mbetjeve të ngurta, etj.), zhvillimin e kapaciteteve, forcimin e institucioneve përmes dhënies së udhëzimeve dhe asistencës në punë, lidhjen e projekteve të manaxhimit mjedisor me konceptin e partneritetit publik-privat, etj.

Politika Publike, Punë Kërkimore dhe Advokim - Puna kërkimore përbën një pjesë integrale dhe të gjërë të punës metodologjike dhe projekt-portofolit të Co-PLAN. Krahas punës kërkimore të ekspertëve dhe asaj të lidhur me projekte kërkimore të mbështetur nga agjenci të ndryshme donatore, puna kërkimore lidhet me çdo projekt si: studime fizibiliteti, vlerësime mjedisore dhe auditime, të fokusuara mbi planifikimin, proceset me pjesëmarrje, qeverisjen vendore, ofrimin e shërbimeve, etj. Co-PLAN është pjesë e Institutit për Kërkim dhe Zhvillim të Universitetit POLIS - POLIS IKZH dhe ka një agjendë kërkimore të konsoliduar e cila rishikohet vazhdimisht, brenda interesave, prioriteteve dhe angazhimeve vjetore të Co-PLAN.



Bordi Drejtues



Dr. Sokol Çelo
(Drejtor)

Kryeson Bordin Drejtues të Co-PLAN që nga viti 2002. Aktualisht punon si Asistent Profesor i Manaxhimit të Biznesit Ndërkombëtar në Suffolk University, Boston, SHBA. Dr. Çelo, matematicien nga kualifikimi, thelloi studimet e tij në fushën e administrimit të biznesit, duke e përqendruar punën e tij kërkimore në vendim-marrjet lidhur me vendin se ku investojnë korporatat multinacionale.



Prof. Dr. Besnik Aliaj
(Anëtar)

Një bashkëthemelues i Co-PLAN dhe Rektori aktual i Universitetit POLIS, Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit, ku ai jep lëndën e projektimit urban. Prof.Dr. Aliaj është planifikues urban, për nga kualifikimet dhe profesioni, autor i shumë botimeve në këtë fushë dhe i ftuar nderi në konferenca të ndryshme ndërkombëtare. Aktualisht ai është anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës.



Doc. Sotir Dharmo
(Anëtar))

Administratori i bordit themelues të Universitetit POLIS si dhe pedagog i dy kurseve: Dizajn Urban dhe Analizë Territori e Vendbanimeve Njerëzore. Është redaktor i periudikut shkencor të U_POLIS, "Forum A + P" dhe angazhohet në punë kërkimore e konsulencë në fushën e planifikimit urban dhe projektimit urban. Gjithashtu, është autor i botimeve të shumta në këtë fushë.





Co-PLAN 2015

Aktivitate





- Aktivitet lançues i Platformës “Financat Vendore”
- Forcimi i Kapaciteteve të Qeverisjes Vendore - Dialog Kombëtar
- Hartimit i Planeve të Përgjithshme Vendore në 5 Bashki - Konsultime dhe Dëgjesa Publike
- Publikimi i Manualit Teknik “Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri
- Aktivitet lançues i Projektit “LëvizAlbania”
- Aktivitete në Rajon
 - . Llogaridhënia Sociale dhe Angazhimi Qytetar - *Workshop* Rajonal (UPP II)
 - . Zgjidhje Novatore për Qytete të Qendrueshme - Dialogu Kombëtar në Kroaci (UPP II)
 - . Prezantimi Publik i Fondit të Artit dhe Kulturës për Ballkanin (BAC)
 - . Aktiviteti dedikuar Hapësirës Publike - Dizajni i Komunitetit në Prishtinë
 - . Konferenca Rajonale e Shoqërisë Civile në Beograd
 - . Konferenca mbi Vlerësimin dhe Taksimin e Pronës për Qendrueshmëri Fiskale dhe Qeverisje Lokale të Përmirësuar
- Bashkëpunime me Universitetin POLIS

Aktiviteti Lançues i Platformës “Financat Vendore”

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave prezantuan Portalin e të Dhënave Financiare të Bashkive. Në këtë aktivitet promovues morën pjesë Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Financave, Zj. Gelardina Prodani; Drejtori i Përgjithshëm i Buxhetimit dhe Financave të Qeverisë Vendore, Z. Fran Brahimi; Këshilltari pranë Ministrit të Shtetit për Çështje Vendore, Z. Enea Hoti; përfaqësues nga Agjencitë Donatore, dhe projektsh, përfaqësues nga disa bashki në vend, Institucione të Arsimit të Lartë, Organizata të Shoqërisë Civile, etj.

Të ftuarit vlerësuan platformën “Financat Vendore” si një instrument shumë të dobishëm në duart e NJQV-ve, OSHC-ve Universiteteve, Profesionistëve dhe ekspertëve të fushës, Studentëve, etj. Përgjatë prezantimit, përfaqësuesit nga dy ministritë u ndalën në rëndësinë e standartizimit të raportimeve financiare për Njësitë e Qeverisjes Vendore për të

lehtësuar mbledhjen, përpunimin dhe krahasueshmërinë mes njërive por dhe mes momenteve të ndryshme në kohë. Zj. Prodani shprehu gatishmërinë e Ministrisë së Financave për të uhqyer platformën e financave vendore me të dhëna në mënyrë sistematike, duke garantuar kështu vazhdimësinë dhe pasurimin e platformës në vite. Financat Vendore është një platformë informacioni për performancën fiskale dhe financiare të njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri që ndërton mbi parimin “Qeverisja e hapur është Qeverisje e Përgjegjshme”.

Platforma mundëson, jo vetëm ndarjen e të dhënave financiare dhe fiskale të njësive të qeverisjes vendore për periudhën 2008 - 2014, por edhe analiza krahasimore të tyre, duke ofruar në këtë mënyrë një instrument të fuqishëm për monitorimin e performancës financiare dhe fiskale të NJQV-ve,

rritjen e transparencës në qeverisje dhe përmirësimin e vendimmarrjes së informuar. Financat Vendore i vijnë në ndihmë Organizatave të Shoqërisë Civile, Niveleve Qeverisëse, Medias, Universiteteve dhe Instituteve Kërkimore, Profesionistëve të fushës, Qyterarëve, Shoqatave të Njësive të Qeverisjes Vendore, dhe aktorëve të tjerë të interesuar për të aksesuar, kuptuar, monitoruar dhe përdorur në mënyrë analitike të dhënat mbi performancën financiare në nivel vendor në Shqipëri.

www.financatvendore.al



Forcimi i Kapaciteteve të Qeverisjes Vendore – Dialog Kombëtar

Banka Botërore në bashkëpunim me Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, organizuan në Tiranë, konferencën një-ditore “Dialogu Kombëtar në Shqipëri-Forcimi i kapaciteteve të qeverisjes lokale në Evropën Juglindore”, në kuadrin e “PROGRAMIT PËR PARTNERITET URBAN II -Banka Botërore, Austri . Ky aktivitet në nivel kombëtar shënoi fillimin e fazës së dytë të Programit të Partneritetit Urban (UPP II) që është duke u zbatuar në Evropën Jug-Lindore dhe adresoi sfidat me të cilat qeveria qendrore dhe vendore është duke u përballur në vijim të zbatimit të reformës administrative dhe territoriale në Shqipëri, Strategjisë së Decentralizimit, dhe problematikave ndërsektoriale që Qeveritë Lokale (LGS), janë duke u përballur në këtë kontekst të veçantë.

UPP II ka për qëllim forcimin e kapaciteteve të qeverive lokale në EJL dhe pajisjen e zyrtarëve të zgjedhur lokalë, administratorët e qytetit dhe stafin teknik me mjete praktike të vendimarrjes,

për menaxhimin efektiv të zhvillimit urban për rritje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Konferenca u mbajt në formën e një dialogu të strukturuar mes përfaqësuesve të qeverisë lokale dhe qendrore, jo vetëm për të adresuar sfidat e përbashkëta në vijim të reformës, por kryesisht për tu përballur me çështjet ndër-sektoriale që njësitë e qeverisjes vendore po hasin në këtë kontekst të veçantë, me qëllimin për të nxitur përfshirjen e aktorëve të ndryshëm qeveritarë, departamenteve specifik (financa, planifikimi, teknika) dhe shoqërisë civile, në mënyrë që të integrohen mjetet dhe qasjet e ndryshme të UPP-së (Vetëvlerësimi Financiar i Bashkive, Llogaridhënia Sociale dhe Angazhimi Qytetar, Auditi Urban, Integritet Urban dhe Antikorrupsioni) në nivel vendor; të mbështetet qeveria vendore në procesin e inventarizimit dhe konsolidimit dhe të ndihmohet në ankorimin e praktikave vetë-vlerësuese si pjesë të praktikës bashkiake. Konferenca u mbajt mbi tre çështje tematike, e ndjekur nga tre panele diskutimi.



Hartimit i Planeve të Përgjithshme Vendore në Berat, Elbasan, Fier, Lushnjë, Kuçovë – Konsultime dhe Dëgjesa Publike

Në kuadër të Projektit për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP), financuar nga USAID Albania, në marrëveshje bashkëpunimi me Qeverinë Shqiptare dhe Bashkitë Berat, Fier, Lushnjë, Elbasan dhe Kuçovë, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, ka nisur procesin e hartimit të Planeve të Përgjithshme Vendore për Territorin, që do të administrohen nga bashkitë e sipër-përmendura, sipas parashikimeve ligjore të ligjit 115/2014 dt. 31.07.2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Për këtë qëllim, dhe në përputhje me kërkesat ligjore, Bashkitë, në bashkëpunim me Co-PLAN dhe me suportin e USAID, organizojnë dëgjesat publike me komunitetin. Këto takime janë të domosdoshme në kuadrin e hartimit të dokumentave të Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Bashkive.

Dëgjesat e para për secilën nga bashkitë u zhvilluan në Tetor të 2015-tës. Të gjithë të interesuarit si: qytetarë, ekspertë të fushave të ndryshme, përfaqësues të qeverisë qendrore dhe vendore, pjestarë të shoqërisë civile, etj. morën pjesë për tu informuar mbi procesin e planifikimit, si dhe për të nisur diskutimet e para në lidhje me zhvillimin e përgjithshëm të bashkisë.

Dëgjesat e dyta publike u realizuan në periudhën Nëntor-Dhjetor të 2015-tës, ku Co-PLAN dhe Bashkitë përkatëse prezantuan gjetjet e analizave paraprake si dhe ndërmorën diskutime mbi draft-vizionin për zhvillimin e bashkisë.

Ndërkohë dëgjesat e treta publike u realizuan në Dhjetor të 2015-tës për bashkitë e Elbasanit dhe Fierit. Në këtë takim u prezantuan gjetjet e analizave përfundimtare si dhe u nxit diskutimi mbi vizionin dhe objektivat strategjike për zhvillimin e bashkisë.





Publikimi i Manualit Teknik “Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri

Manuali teknik “Planifikimi dhe zhvillimi i territorit në Shqipëri” është një dokument i përgatitur nga Co-PLAN në kuadër të projektit të USAID, për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe në ndihmë të vendimmarrësve dhe të profesionistëve të fushës. Ai është hartuar duke respektuar legjislacionin aktual të planifikimit në Shqipëri dhe sjell tre risi: [1] Reflekton legjislacionin e ri të planifikimit, të krijuar prej vitit 2014, duke qenë kështu një udhërrëfyes i përditësuar në funksion të nevojave të bashkive dhe autoriteteve të tjera publike; [2] Ofron një gamë të gjerë metodologjish mbi mënyrën e realizimit të analizave hapësinore/territoriale në planifikimin vendor dhe në lidhje me shumëllojshmërinë dhe zbatimin e instrumenteve të zhvillimit të tokës për financimin e infrastrukturave publike. [3] Sjell një buqetë instrumentesh për zhvillimin e tokës (drejtimin e zhvillimit nëse i referohemi ligjit të planifikimit) dhe sidomos instrumente financiare të zhvillimit të tokës, që synojnë sigurimin e financimit të infrastrukturave publike, përtej mënyrave që bashkitë shqiptare njohin e përdorin aktualisht.



Aktiviteti Lançues i Projektit “LëvizAlbania”

LëvizAlbania organizoi takimin konsultues për diskutimin e Planit Vjetor të Veprimtarisë (2015-2016) në Tetor të 2015-tës. Në këtë aktivitet të parë zyrtar të projektit, u diskutuan gjerësisht aktivitetet për vitin e parë të punës.

Në fjalën përshëndetëse, Z. Andi Dobrush, Drejtuesi Ekzekutiv i OSFA dhe drejtuesi i Konsorciumit zbatues të projektit (OSFA, Co-Plan, Partnerët Shqiperi), theksoi se ky projekt katër-vjeçar i financuar nga Ambasada e Federatës së Zvicrës

në Tiranë, vjen në kohën e duhur, kur shoqëria civile, sidomos ajo jashtë kryeqytetit, ka nevojë për t’u rritur, mbështetur dhe për të ngritur më tej kapacitetet; Reforma Administrative dhe Territoriale, e cila ka hapur përpara mjaft mundësi, por edhe problematika të ndryshme shtrën nevojën që shoqëria civile të ketë zërin e saj, për të siguruar një qeverisje të mirë në nivel vendor dhe jo vetëm.” Përfaqësuesja e Ambasadës Zvicerane, Znj. Debora Kern, nxorri në pah rëndësinë që ka roli i shoqërisë civile

për zhvillimin e demokracisë vendore. Ekipi i LëvizAlbania, Znj. Elda Kalaja dhe Znj. Orjada Tare prezantuan Planin Vjetor të Veprimtarisë duke dhënë njëherësh edhe qëllimin e objektivat e Projektit. Të pranishmit diskutuan gjerësisht aktivitetet e parashikuara, duke synuar arritjen e një sinergjie me programet ekzistuese. Në takim morën pjesë rreth 40 të ftuar nga organizata të shoqërisë civile, pushteti vendor, përfaqësues të qeverisjes qendrore, organizatat ndërkombëtare, etj.



Aktivitete në Rajon

Llogaridhënia Sociale dhe Angazhimi Qytetar - Workshop Rajonal (UPP II)

Workshop-i Teknik (Trajnim për Trajnerët - ToT) ishte aktiviteti i parë rajonal, i cili shënoi nisjen e projektit të Qëndrueshmërisë Sociale dhe Angazhimit Qytetar (SSCE), një tjetër komponent i fazës së dytë të Programit të Partneritetit Urban, i Bankës Botërore Austri (UPP II).

Workshop-i shërbeu për nisjen e fazës së dytë të projektit, por shërbeu edhe si një mundësi e mirë për të sjellë së bashku të gjithë aktorët e përfshirë, si përfaqësuesit e Bankës Botërore, konsorciumin e projektit (Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe IZUD, Instituti për Zhvillimin Urban Ndërkombëtar), ekipet lokale të qyteteve, si dhe përfaqësues nga bashkitë nga grupi i I-rë, i fazës së parë të projektit (konkretisht Durrësin, Prishtinën, Sarajevën, dhe Shkupin). Workshop-i funksionoi si një tryezë e rumbullakët për konsultime, diskutime dhe rishikime në kuadër të metodologjisë së projektit, aktiviteteve dhe përpjekjeve të përbashkëta operative.

Aktiviteti u përqëndrua në aspektet e veçanta metodologjike të zhvilluara nga faza e I-rë e UPP-së, (Auditimi i Llogaridhënies Sociale), konkretisht mbi modelin hulumtues për hartimin e raportit analizues të qytetit, pyetësorët e diskutimeve me fokus grupet dhe intervistat, workshop-in e Skenaravë të Zhvillimit me Pjesëmarrje dhe indeksin e llogaridhënies sociale. Qëllimi i këtij workshop-i lidhet me mobilizimin e ekipeve lokale për secilin qytet dhe për zbatimin e SSCE rreth një përmbajtje të përbashkët si dhe specifikimin e rolit dhe detyrave të tyre si trajnerë, këshilltarë dhe lehtësues përgjatë procesit.

Për më tepër, seminari shërbeu për rifillimin e procesit të rishikimit të Planeve të Veprimit për grupin e qyteteve të fazës së I-rë të UPP-së, konkretisht me ekipet e qytetit dhe përfaqësues të pushtetit vendor nga Durrësi, Prishtina, Sarajeva, dhe Shkupi.



Zgjidhje Novatore për Qytete të Qendrueshme - Dialogu Kombëtar në Kroaci (UPP II)

Banka Botërore, në bashkëpunim me Shoqatën e Qyteteve Kroate, organizoi aktivitetin e Dialogut Kombëtar, me fokus kryesor forcimin e kapaciteteve të qeverive lokale. Konferenca e mbajtur më 9-10 Korrik të 2015-tës në Porec, Kroaci, shënoi dhe fillimin e fazës së dytë të Programit të Partneritetit Urban (UPP II), iniciative e Bankës Botërore-Austri. UPP II ka për qëllim forcimin e kapaciteteve të qeverive lokale në rajonin e Europës Juglindore, dhe të pajisë zyrtarët e zgjedhur lokalë, administratorët e qytetit dhe stafin teknik me mjete praktike për vendimmarrjen, për të menaxhuar efektivisht zhvillimin urban për rritje ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Edhe pse me përmasa globale, ky program targeton vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, e përfaqësuar në aktivitet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

Objektivi i Dialogut Kombëtar në Kroaci ishte diskutimi i prioritetëve strategjike të ministrive përkatëse në fushën e zhvillimit të pushtetit lokal dhe lehtësimi

i dialogut mes dy niveleve të qeverisjes, për të avancuar me axhendën në lidhje me çështjet e financave lokale, investimeve prioritare, menaxhimit të aseteve, qeverisjes urbane dhe forcimit të integritetit, llogaridhënies sociale dhe angazhimit qytetar. Përveç kësaj, takimi ofroi një mundësi për të paraqitur rezultatet e fazës së parë të Programit të Partneritetit Urban dhe angazhimit të aktorëve kryesorë në fazën e dytë.

Co-PLAN u përfshi në aktivitet në cilësinë e një prej organizatave lokale zbatuese të dy komponentëve të fazës së parë të UPP-së, duke ndarë përvojën e zbatimit të suksesshëm të dy projekteve në këtë kuadër: MFSA (Vetëvlerësimi i financave bashkiake) dhe SSA (Auditimi i Qëndrueshmërisë Sociale). Për më tepër, Co-PLAN është e angazhuar në fazën e dytë të programit (UPP II), duke zbatuar në bashki të ndryshme të Shqipërisë tre (nga katër në total), komponentë të UPP II, përkatësisht MFSA, SSCE (Qëndrueshmëria Sociale dhe Angazhimi Qytetar) dhe UA (Auditimi Urban).



Prezantimi Publik i Fondit të Artit dhe Kulturës për Ballkanin (BAC)

Nisma e Fondit të Artit dhe Kulturës për Ballkanin (BAC), mbështetur nga Qeveria Zvicerane, Fondacioni Kulturor Evropian (ECF) dhe Artzngle, u prezantua në Shkurt të vitit 2015 në Galerinë e Arteve në Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë. Një numër i madh i organizatave partnere, rrjetet e artistëve nga i gjithë rajoni, përfaqësues të organizatave dhe misioneve ndërkombëtare, përfaqësues të Medias, morën pjesë në këtë aktivitet. Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit ishte ftuar në mesin e organizatave të tjera për të prezantuar projektin e saj (Iniciuesi, Artisti, Advokuesi dhe urbanisti-IAAU), i promovuar mes praktikave/projekteve më të mira, së bashku me projektin e Generator, OJF që operon në Serbi. Projekti fokusohej në rivitalizimin kulturor, ekonomik, shoqëror dhe hapësinor në lagjet e brëndshme të qytetit të Tiranës të lëna pas dore.



Aktiviteti kishte për qëllim të sillte së bashku njerëz dhe organizata të cilat punojnë që të afrojnë njerëzit më pranë duke investuar në kulturë, dhe të krijojnë dhe promovojnë iniciativa kulturore dhe artistike. Gjatë aktivitetit u theksuan lidhjet e forta ndërmjet komuniteteve për sigurimin e një shoqërie civile të gjallë, të angazhuar dhe të qëndrueshme. "Shprehja e Pavarur artistike dhe puna kulturore mund të udhëheqë forcat shoqërore në ndërtimin e demokracisë, sigurisë dhe prosperitetit duke u orientuar vetëm drejt ardhmes", tha drejtori i Bashkëpunimit të Ambasadës së Zvicrës në Bosnje dhe Hercegovinë, Joseph Guntern.

Aktiviteti dedikuar Hapësirës Publike - Dizajni i Komunitetit në Prishtinë

Simpoziumi 3-ditor i Dizajnit të Komunitetit u organizua nga Universiteti Amerikan në Kosovë, në partneritet me Qendrën Komunitare të dizajnit - Rochester më datat 6-8 Maj 2015, me përkrahjen e Ambasadës Amerikane në Kosovë. Pjesëmarrës të shumtë nga qeveria qendrore dhe vendore, agjencitë kombëtare, institutet kërkimore dhe universitetet, organizatat ndërkombëtare dhe vendore, ndanë ide, startegji dhe përvojat e tyre profesionale në lidhje me rivitalizimin urban. Aktiviteti shërbeu si promotor i një modeli të zhvillimit të Prishtinës dhe qyteteve të tjera në rajon, ku qytetari duhet të jetë plotësisht i angazhuar.



Co-PLAN, së bashku me pjesëmarrësit e tjerë, të cilët punojnë në fushën e planifikimit urban dhe hapësitor, dizajn, arkitekturë, art, ligj dhe politikë, ndanë idetë dhe modele të suksesshme të dizajnit të komunitetit dhe planifikimit urban në Evropë dhe Amerikën e Veriut. Për më tepër u diskutuan çështjet e planifikimit hapësitor dhe zhvillimit urban, si ato lidhen me mjedisin e ndërtimeve, efikasitetin e energjisë dhe dizajnin e qëndrueshëm. Dizajni i Komunitetit Prishtinë nuk ofroi vetëm një platformë për të gjeneruar ide, por mbi të gjitha mundësoi bashkëpunime dhe pasqyroi modelet për charrette të së ardhshmes së projektimit në qytete të tjera në Ballkan.

Konferenca Rajonale e Shoqërisë Civile-Beograd

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2015 në kontekstin e Ballkanit

Co-PLAN, së bashku me një grup organizatash të shoqërisë civile nga vendet e Ballkanit Perëndimor, aktive në fushën e uljes së varfërisë, fuqizimit të grupeve të marginalizuara të shoqërisë, përfshirë gratë dhe romët, mbrojtjen e mjedisit, arsimit, si dhe kundër korrupsionit, mbrojtjes së transparencës dhe të drejtave të njeriut, u mbledhën në Beograd më 26 Qershor të 2015-tës për të nisur një thirrje të përbashkët drejtuar qeverive respektive, në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së për 2015-tën, për të: (1) *Votuar për miratimin e Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Asamblenë e Përgjithshme të OKB në Shtator të 2015-tës*; (2) *Bërë përpjekje shtesë - derisa vendimi përfundimtar të merret nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së - duke advokuar me vendet e tjera për të mbështetur listën e propozuar të qëllimeve post-2015, përfshirë Pikën 16: Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, drejtësi për të gjithë dhe të ndërtim institucionesh efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet*; (3) *Nisur një proces gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës për të vendosur objektiva kombëtare dhe planet e veprimit në lidhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm sapo ato të jenë aprovuar në OKB*; (4) *Forcuar bashkëpunimin rajonal dhe ndërtuar partneritete në të gjitha fushat ku për arritjen e qëllimeve kombëtare kërkohet përpjekje e përbashkët dhe sinergji*.

Gjatë konferencës, të gjithë pjesëmarrësit ndanë pikëpamjet e ngjashme sesi objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm adresojnë çështje si ç'rrenjosja e varfërisë, zhvillimi i shëndetësisë, arsimit, barazisë gjinore, mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, punësim, energji eficiente, drejtësi për të gjithë, institucione efektive në të gjitha nivelet dhe partneritet global për zhvillim të qëndrueshëm. Duke pranuar se këto objektiva mund të kthehen në një axhendë të vërtetë transformuese për Ballkanin Perëndimor vetëm kur angazhimet globale të gjejnë vendin e tyre në politikat kombëtare, planet dhe masat e veçanta lokale, dhe kur burime të mjaftueshme financiare janë alokuar për zbatimin e tyre, organizatat e shoqërisë civile u dakortësuan me formatin e mësipërm përmbajtësor në thirrjen drejtuar qeverive përkatëse.




Platforma “Tirana për Qytetarët”

TIRANA PËR QYTETARËT, është një platformë e hartuar dhe ndarë nga Co-PLAN në Prill të vitit 2015, në prag të zgjedhjeve lokale në vend. Kjo platformë merr shkas nga reforma administrative-territoriale dhe ajo e planifikimit, dhe ofron ide themelore mbi zhvillimin e Tiranës dhe vizionin e saj të rritjes. Gjithashtu, “Tirana për Qytetarët” është një kontribut për axhendat elektorale të kandidatëve në zgjedhje vendore të 2015-tës, dhe synon të ushqejë kontratën e kandidatit apo kryetarit të ardhshëm me qytetarët e tij, por nuk merr përsipër të shterojë programe politike apo menaxheriale të qeverisjes vendore.

E pasur në programe dhe projekte për të ardhmen, kjo platformë reflektohet në kosto zbatimi dhe nevojë bashkëpunimi dhe partneriteti ndër-institucional e shumë-aktorësh. Një koncept modern i qeverisjes në shumë nivele do të mundësojë që kjo platformë me 6 programe të hedhë shina të qarta e të qëndrueshme për të ardhmen e një Tirane të jetueshme.

Programet e platformës përfshijnë çështje si: (1) Tirana-Nyje graviteti në rajon; (2) Një vizion i ri për territorin- transformimet e mëdha; (3) Një ekonomi dinamike dhe vetëpërshtatëse; (4) Agjendat e zhvillimit të lagjeve; (5) Tirana e Software social ripërtëritës; (6) Eco-Hapësira: Një territor-një organizëm

Të gjitha këto programe synojnë të promovojnë një model qyteti nën konceptin e “Tiranës për Qytetarët”, i cili duhet të jetë qytet idesh të freskëta, vizionare, transformuese, moderne dhe gjithëpërfshirëse; lideve që tejkalojnë debatin politik, si një qasje e vjetëruar në manaxhimin e qytetit; lideve që promovojnë shoqërinë e vërtetë civile, komunitetin dhe demokratizimin shoqëror.



Konferenca mbi Vlerësimin dhe Taksimin e Pronës për Qendrueshmëri Fiskale dhe Qeverisje Lokale të Përmirësuar - Vilnius, Lituani

Co-PLAN mori pjesë në Konferencën mbi Vlerësimin dhe Taksimin e Pronës për Qendrueshmëri Fiskale dhe Qeverisje Lokale të Përmirësuar. Konferenca u organizua nga Banka Botërore në bashkëpunim me Organizatën për Ushqim dhe Bujqësi të Kombeve të Bashkuara, në Lituani. Qëllimi i Konferencës ishte të përmirësonte të kuptuarit të sistemit të vlerësimit të pronave në rajonin e Evropës lindore dhe Azisë qendrore, sfidat që hasen gjatë procesit zhvillimor, ndikimin e tyre mbi taksimin e pronës, si dhe aftësinë për të përmirësuar financat bashkiake dhe qeverisjen vendore në përgjithësi. Përgjatë konferencës, Co-PLAN prezantoi një rast studimor bazuar mbi studimin e kryer mbi Taksimin e Pronës në Shqipëri. Vende si Kroacia, Lituania, Moldova, Turqia, Serbia, Kazakistani dhe Holanda po ashtu ndanë eksperiencat e tyre në këtë fushë përmes rasteve studimore që prezantuan.

Prej viti 2014, Banka Botërore, FAO dhe Qendra e Regjistrave të Lituani kanë punuar në një projekt të njohurive mbi taksimin e pronës dhe vlerësimi në Evropën Qendrore dhe Azinë (ECA) rajon. Nisma është financuar nga Fondi rajonin ECA të Bankës Botërore për Programore Mirëbesimit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Banka Botërore - Programi FAO i Bashkëpunimit. Një sistem vlerësim në gjendje të gjenerojë vlerësime të drejta dhe në kohën e duhur të vlerës, përbën një parakusht për vendim-marjen bazuar në para, si dhe për pyetje që ngrihen në një juridiksion të caktuar si pjesë e qeverisjes së përgjegjshme.



**PROPERTY TAXATION
IN ALBANIA**

**L'IMPOSITION
FONCIÈRE EN ALBANIE**

**TRIBUTACIÓN DE
BIENES RAÍCES EN
ALBANIA**



Food and Agriculture Organization
of the United Nations



WORLD BANK GROUP

**LAND
TENURE
JOURNAL**

**REVUE DES
QUESTIONS
FONCIÈRES**

**REVISTA SOBRE
TENENCIA DE
LA TIERRA**

2.15

ISSN 2079-7168



PROPERTY VALUATION
AND TAXATION FOR
FISCAL SUSTAINABILITY
AND IMPROVED LOCAL
GOVERNANCE in the Europe
and Central Asia region

PROPERTY TAXATION AND
VALUATION IN LITHUANIA

PROPERTY VALUATION
AND TAXATION IN THE
NETHERLANDS

PROPERTY ASSESSMENT
AND TAXATION IN THE
REPUBLIC OF MOLDOVA

THE PROCESS OF
INTRODUCING A MODERN
REAL PROPERTY TAX IN
SLOVENIA

PROPERTY TAXATION IN
POLAND: legislation
without implementation

REAL PROPERTY TAXATION
IN THE REPUBLIC OF
KAZAKHSTAN

PROPERTY VALUATION AND
TAXATION FOR IMPROVING
LOCAL GOVERNANCE IN
TURKEY

SERBIA: CASE STUDY ON
PROPERTY VALUATION AND
TAXATION

PROPERTY TAXATION IN
ALBANIA

Bashkëpunimi me Universitetin POLIS

Javët e Dizajnit në Tiranë 2015

TDW-Tirana Design Week është event i parë totalisht i dedikuar dizajnit në Shqipëri, dhe është krijuar me qëllim për të atakuar manifestimet e kreativitetit me një fokus specifik në kontekstin bashkëkohor. Javët e Dizajnit në Tiranë 2015 u organizuan nga Universiteti Polis, në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Tiranës, Ministrinë e Kulturës. Ministrinë e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale, Institutin Italian të Kulturës në Tiranë dhe Co-PLAN. TDW është një event dyvjeçar që sjell një seri ngjarjesh në qytet me qëllim shkëmbimin e njohurive midis profesionistëve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për të rritur interesin publik mbi dizajnin, arkitekturën dhe artizanatin, si disiplina që janë të lidhura ngushtë me zhvillimin kontemporan të imazhit të qyteteve; si dhe rritjen e pjesëmarrjes në vendim-marrje dhe të zhvillimit të proceseve. Qëllimet e TDW janë:

- Të fuqizojë fushat e Dizajnit, Arkitekturës, Artit dhe Kulturës si elemente kyçe në proceset e zhvillimit dhe integritit të qyteteve në Shqipëri dhe më tej në rajon;
- Të promovojë kulturën e dizajnit shqiptar dhe praktikën e artit në rrjetin e partnerëve rajonal dhe ndërkombëtar;
- Të shkëmbejë përvojat ndërkombëtare /kombëtare në fushën e dizajnit, arkitekturës, artit në përgjithësi, si dhe teorinë konceptuale të qyteteve bashkëkohore, duke u fokusuar në kontekstin e dinamikave sociale, kulturore, ekonomike dhe rolin e dizajnit në promovimin e tyre
- Të rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve në dizajn nëpërmjet proceseve krijuese duke rritur shkallën dhe llojet e

shkëmbimit ndërmjet qytetarëve dhe qytetit. Këto procese krijuese mund të përfshijnë zëjtari, aktivizimin urban, art publik, dhe ndërhyrje afatshkurtëra ose afatgjata në qytet.

Javët e Dizajnit në Tiranë 2015 u konceptuan në katër grupe aktivitete kryesore: Aktivitete të arkitekturës, Aktivitete Arti dhe Dizajni, Punëtori, (workshops), dhe Aktivitete Publike. Secili prej tyre përbëhet nga një numër aktivitete të formave të ndryshme si: konferenca, ekspozita, konkurse, leksione, forume të hapura, etj. Aktivitetet u mbështetën dhe zhvilluan në bashkëpunim me një sërë ekspertësh ndërkombëtar si Matteo Ragni, Giuseppe Mincolelli, Atelier Crilo, Jayson Payne, Danica Karaicic, Neil Denari, Elisa Leoncini, nga datat 14 Shtator deri më 3 Tetor 2015.



Projekte





1. Projekti për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore në Shqipëri (PLGP)
2. Platforma ENV.net në Ballkanin Perëndimor
3. Demokracia në Veprim: Aktivizmi Urban për Demokraci Qytetare
4. Vetëvlerësimi Financiar Vendor (MFSA) dhe Auditi Urban (UA)
5. Qëndrueshmëria Sociale dhe Angazhimi Qytetar nën UPP II
6. Monitorimi sistematik i gjëndjes financiare dhe Praktika e menaxhimit financiar në nivel vendor
7. Zhvillimi dhe Përshtatja e Programeve Profesionale mbi Efijçencën e Energjisë në Ballkanin Perëndimor
8. TraSaCu - Kultura e Sigurisë Rrugore
9. Hartimi i Planeve Operative të Zhvillimit Lokal (POZHL) për Njësitë e sapoformuara të Qeverisjes Vendore në Shqipëri
10. dldp II: (Komponenti i Mbetjeve të Ngurta) Zhvillimi i Skemave Ndërvendore dhe Modeleve të Kompostimit, në zonën e Pukës dhe në zonën e Malësisë së Madhe

Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore në Shqipëri (PLGP)

Periudha e zbatimit: 2015 -2017

Donator: USAID

Fondi: 2.513.341 USD

Zbatuar në: Bashkitë e Fierit, Lushnjes, Beratit, Kuçovës, Elbasanit

Zbatuar nga: Tetra Tech ARD dhe Co-PLAN

Programi i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore i siguron asistencë teknike qeverisë Shqiptare dhe qeverive vendore të përzgjedhura në zhvillimin e kapaciteteve dhe njohurive teknike për hartimin e planeve territoriale, në përputhje me Ligjin për Planifikimin e Territorit. Programi gjithashtu ofron asistencë teknike për Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për të zhvilluar një kuadër konceptual për Planin Kombëtar të Territorit në përputhje me Ligjin dhe rregulloret zbatuese. Nëpërmjet këtij programi i është dhënë një mundësi më e madhe pjesëmarrëse grupeve të interesit, si qytetarëve, shoqërisë civile, bizneseve dhe grupimeve të tjera, në mbikëqyrjen e planifikimit territorial. PLGP gjithashtu ofron asistencë teknike për 5 Planet e Përgjithshme Vendore (PPV) për bashkitë Fier, Lushnje, Berat, Kuçovë, Elbasan. Planet e përgjithshme territoriale janë konceptuar si dokumente gjithëpërfshirëse dhe integruese, me projekte specifike, të hartuara në mënyrë që autoritetet vendore dhe qytetarët të planifikojnë më mirë çështjet sociale, ekonomike, fizike, politike, estetike dhe çështje të tjera që ndihmojnë arritjen e objektivave të përgjithshme të zhvillimit të bashkive. Co-PLAN ka punuar intensivisht me të pesta bashkitë pilote për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve në lidhje me hartimin e planeve, duke nisur me ngritjen e bazës së të dhënave në Sistemin Informativ Gjeografik (GIS), e duke vazhduar me hartimin e strategjive të zhvillimit dhe planeve territoriale rregullatore.

Gjatë vitit 2015, disa nga arritjet kryesore dhe rezultatet e Programit të Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore janë:

Krijimi i strukturës institucionale funksionale për përgatitjen e Planeve Vendore Territoriale ndërmjet Co-PLAN, USAID, Ministrisë së Zhvillimit Urban, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, dhe aktorëve të tjerë kombëtar.



Mbështetja e Bashkive në ndërmarrjen e iniciativës për hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore

Krijimi i Bazës së të dhënave territoriale dhe kryerja e analizave për çdo document të planifikimit territorial, ku Co-PLAN në bashkëpunim me 5 bashkitë, ka mbledhur dhe përpunuar të dhënat, mbi bazën e të cilave ka kryer analiza të detajuara mbi territorin, mjedisin, kushtet socio-ekonomike, etj.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për pesë bashkitë

Mbajtja e Dëgjësave Publike -Në përputhje me kërkesat ligjore, të pesta Bashkitë, të asistuar nga Co-PLAN kanë organizuar një numër dëgjësash publike me komunitetin në kuadrin e hartimit të dokumenteve të Strategjisë së Zhvillimit të Territorit.

Formulimi i pesë dokumenteve të Strategjisë së Zhvillimit të Territorit, Hartave dhe Rregulloreve

Formulimi i Politikave të Territorit për miratim në Këshillin Bashkiak



Platforma ENV.net në Ballkanin Perëndimor

Periudha e Zbatimit: Dhjetor 2014 -31 Janar 2016

Donator: EU

Fondi: 644,766.00 EUR

Zbatuar në: Ballkanin Perëndimor dhe Turqi

Zbatuar nga: Punto.sud (IT), ATRC (KS) - Partner, Co-PLAN (AL) - Partner, EASD (SRB) - Partner, EEB (BE) - partner mbështetës, TEMA (TR) - Partner, BALKAN për Urat 4x4x4 (MK) - partner

Gjatë vitit 2015, Co-PLAN ka vazhduar me implementimin e fazës së dytë të “zhvillimit të platformës ENV.net në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: duke i dhënë qytetarëve një zë për të ndikuar reformat procesit mjedisor për integrim më të afërt në BE”. Kjo fazë, ndër të tjera, është fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e ndjeshme në lidhje me mjedisin dhe identifikimin e mangësive të mundshme në përafrimin e legjislacionit mjedisor. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të nxisë integrimin e vendeve partnere (përfshirë Shqipërinë) në BE dhe përafrimin e tyre drejt legjislacionit europian nëpërmjet ankorimit të vlerave dhe strukturave demokratike, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe përfshirjen sociale në një shoqëri civile më aktive dhe dinamike. Roli i Co-PLAN në fazën e dytë u fokusua në dhënien qytetarëve një zë për të ndikuar në procesin e reformës publike në fushën e mjedisit, nëpërmjet paraqitjes së analizave bazuar në fakte, raporteve të monitorimit dhe advokimit. Gjatë vitit 2015, u zhvilluan këto aktivitete në shkallë kombëtare: [1] Krijimi i pesë buletinëve/ fletëpalosjeve të prodhuara në nivel vendi, duke mbuluar informacion të rëndësishëm në lidhje me legjislacionin mjedisor dhe zhvillimet e fundit në këtë fushë; [2] Organizimi i 2 aktiviteteve në natyrë në kuadër të projektit ENV.net në vitin 2015, si ishte: Dita e Ujit në Lagunën e Karavastasë dhe Dita e Kompostimit në Bashkinë Pukë. Të dyja aktivitetet kishin qëllim për të informuar dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi çështje të ndryshme mjedisore, të tilla si sistemet e kompostimit të mbetjeve, riciklimit dhe praktikave të qëndrueshme të deponimit të mbeturinave në Pukë, dhe menaxhimin e mjedisit dhe ndotjen në Lagunën e Karavastasë; [3] është hartuar një dokument për ndikim në politika për gjendjen e mjedisit në Shqipëri



Aktivitete të tjera të organizuara në nivel rajonal janë:

- Organizimi i njëkohshëm i aktiviteteve në secilin prej vendeve partnere në ditë të caktuara ndërkombëtare mjedisore, duke përfshirë qytetarët
- Krijimi dhe realizimi i 2 kurseve mësimore në platformën digitale e-learning
- Organizimi i fushatave të advokimit ENV.net me OSHC-të dhe autoritetet lokale / kombëtare në temat kyçe të zgjedhura, duke përfshirë cilësinë e ujit dhe ndryshimeve klimatike
- Përgatitja e dokumentave të ngjashme ENV.net dhe përditësim i vazhdueshëm i profilit të secilit vend në raport me progresin e platformës.
- Ngritja e platformës në rrjet të matricës së monitorimit. Qëllimi kryesor i platformës është që të mbledhë informacion nga partnerët ENV.net në transpozimin dhe zbatimin e pjesëve kombëtare të legjislacionit për të monitoruar procesin e përafrimit drejt legjislacionit mjedisor të BE-së dhe për të formuluar rekomandime në këtë drejtim. Ai fokusohet në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi.

Informacioni i detajuar mbi gjendjen e mjedisit në çdo vend mund të shihet këtu: <http://monitoringmatrix.env-net.org/>

Demokracia në Veprim: Aktivizmi Urban për Demokraci Qytetare

Periudha e Zbatimit: 2014 – 2015

Donatori: Ambasada Amerikane në Tiranë, përmes Komisionit të Granteve për Demokracinë

Fondi: 42,100 USD

Zbatuar në: Tiranë, Shqipëri

Zbatuar nga: Co-PLAN

Projekti “Demokracia në Veprim: Aktivizmi Urban për Demokraci Qytetare” trajton nevojën e komunitetit për të marrë përsipër rolin përkatës dhe përgjegjësitë në proceset e bërjes së qytetit, përmes rritjes së pjesëmarrjes në proceset që identifikojnë, rrisin, dhe adresojnë çështje me interes të përbashkët komunitar. Ky projekt synon të arrijë objektivat e tij përmes një qasje praktike pjesëmarrëse, konsultime të ngushta hap-pas-hapi me komunitetin, dhe një seri veprimesh aktive origjinale urbane, ndjekur nga ndërhyrjet konkrete urbane, ku adresohet një çështje e veçantë shqetësimi për komunitetin. Shtrirja dhe natyra e aktivizmave urbane, ndërhyrjet konkrete në të paktën pesë fusha, u përcaktuan në bashkëpunim me komunitetin, i cili gjithashtu morri pjesë në zbatimin e aktivizmit urban (zgjidhjes). Proçesi, shembujt e aktivizmit urban dhe mësimet e nxjerra u shpërndanë gjerësisht përmes mediave, një botimi të dedikuar, dhe një dokumentari me metrazh të gjatë. Qëllimet e këtij projekti janë: [1] Forcimi i rolit dhe përgjegjësisë të qytetarëve, si elemente kyçe në demokracinë lokale dhe proceset e zhvillimit dhe integritetit të qyteteve tona; [2] Transmetimi mes qytetarëve të kulturës pjesëmarrëse në proceset e qytet-bërjes, duke rritur qëllimin dhe shumëllojshmërinë e ndërveprimit të qytetit me qytetarët, përmes mjeteve të aktivizmit urban, artit publik dhe ndërhyrjeve të strukturuar në qytet. Disa nga aktivitetet dhe rezultatet gjatë vitit 2014-2015 janë:

- Realizimi i një anketimi i 5 grupeve të ndryshme komunitare në qytetin e Tiranës;
- Mbajtja e mbi dhjetë konsultimeve me komunitetin në ato vënde ku ndodhën ndërhyrjet urbane.

- Organizimi i 5 performancave në rrugët dhe zonat e ndryshme të qytetit të Tiranës, duke adresuar disa çështje, si: hapsirat publike, kultura e sigurisë në trafikun rrugor, etj.
- Zhvillimi i një metodologjie në formën e një loje, për të lehtësuar proceset me pjesëmarrje të komunitetit, të quajtur “Të luajmë lagjesh”.
- Zhvillimi i 5 projekteve të prekshme teknike për ndërhyrje urbane në një workshop të dedikuar me profesionistë, pjesëtarë të komunitetit dhe studentë të Arkitekturës dhe Artit nga Universiteti POLIS.
- Majtja e një aktiviteti inaugurues në zonën ku u bë ndërhyrja dhe paraqitja e pamjeve para ndërhyrjes për komunitetin dhe autoritetet e ftuara, për të shënuar përfundimin e suksesshëm të ndërhyrjes urbane, dhe për të kaluar pronësinë e rezultatit te vetë komunitetit.
- Majtja e aktivitetit përfundimtar në formën e një ekspozite multimediale, prezantimi i dokumentarit të plotë në ekran dhe ndarja e momenteve dhe proceseve kryesore të aktivistëve urbane dhe të gjitha ndërhyrjet e rehabilitimit të kryera nga Co-PLAN gjatë viteve. Kjo ngjarje u përshëndet edhe nga prania e vlerësuar e zëvendësambasadorit amerikan në Tiranë Z. Henry D. Jardine.



Vetëvlerësimi Financiar Vendor (MFSA) dhe Auditi Urban (UA)

Periudha e zbatimit: 2015-2016

Donator: Banka Botërore

Fondi: 28.070 USD

Zbatuar në: Bashkitë e Beratit, Lushnjes, Elbasanit, Kuçovës dhe Fierit

Zbatuar nga: Co-PLAN

Ky projekt vjen si një iniciativë e Qeverisë austriake në partneritet me Bankën Botërore, me qëllim përforcimin e kapaciteteve për zhvillimin urban në Europën Jug-Lindore. Qëllimi kryesor zhvillimor i Programit të Partneritetit Urban (UPP) është pajisja e zyrtarëve të zgjedhur vendorë, administratorëve të qytetit dhe stafit teknik me kapacitete dhe aftësi për të menaxhuar në mënyrë efektive zhvillimin urban për rritje ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, në përputhje me zhvillimin e reformave progresive urbane. Qëllimi i projektit është që Programi të mundësojë shkëmbimin e njohurive, trajnimin, dhe praktika e reforma të përmirësuara, në kushtet e ndryshimeve të shumta territoriale në vendet ku po zbatohet. Edhe pse me përmasa globale, ky program është vënë në zbatim në Evropës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Kroacinë, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Faza e parë e Programit (2011-2014) u karakterizua nga kërkesat e bashkive dhe shoqatave të qeverisjes vendore, dhe u përqendrua në dimensionet kyçe të qeverisjes vendore, përfshi financave bashkiake, planifikimin urban dhe menaxhimin e tokës, qeverisjen urbane / antikorrupsionin, dhe përgjegjshmërinë sociale. Faza e dytë e UPP-së ka për qëllim të përshkallëzojë përdorimin e këtyre mjeteve diagnostikuese dhe synon që ti ankorojë ato si pjesë e praktikës qeverisëse të bashkive. Si pjesë e UPP II, MFSA dhe UA do të aplikohet në 5 bashkitë e vendit, përkatësisht në Berat, Lushnje, Elbasan, Kuçovë dhe Fier. Këto bashki janë përzgjedhur në bazë të interesimit të shprehur për kryerjen e UA dhe MFSA në territoret e tyre dhe janë konfirmuar nga Banka Botërore. Qëllimi i projektit është që të mbledhë dhe analizojë të dhënat vendore financiare dhe nevojat



prioritare për investime në nivel vendor, me qëllim që të plotësohen formularët e MFSA dhe UA, të cilët shërbejnë si pasqyra të profileve të qyteteve dhe mund të përdoren për aksesim fondesh dhe si prezantime për investitorët e huaj. Informacioni do të mbledhet për secilën prej bashkive të vjetra dhe do të analizohet edhe për bashkitë e reja, të themeluara pas reformës administrative dhe territoriale. Co-PLAN ofron udhëzime dhe asistencë për bashkitë në plotësimin e formularëve.

Disa nga aktivitetet kryesore dhe rezultatet e realizuara gjatë vitit 2015 janë: Rishikimi dhe miratimi i formularëve MFSA me legjislacionin e ri, ndryshimet fiskale dhe funksionale të qeverisjes vendore pas reformës; Bashkëpunimi me 5 bashkitë partnere (me ekspertë të Planifikimit Urban) për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave territoriale (tokës / infrastrukturës) në nivel vendor për të përfunduar analizën UA; Mbledhja e të dhënave dhe analizave paraprake të financave vendore të 5 bashkive partnere; Organizimi i 1 seminari teknik me 5 bashkitë partnere, duke ndarë progresin e secilës bashki në lidhje me MFSA dhe UA; Organizimi i konferencës “Dialogu Kombëtar”, duke kontribuar në diskutimet e vazhdueshme mbi Reformën Territoriale, qeverisjen e përmirësuar dhe vendimmarrjen me pjesëmarrje, duke futur MFSA dhe UA si mjete diagnostikuese për lehtësimin e proceseve të tilla.



Qëndrueshmëria Sociale dhe Angazhimi Qytetar nën UPP II

Periudha e zbatimit: 2015-2016

Donator: Banka Botërore

Fondi: 199.995 (USD)

Zbatohet në: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Serbi, Bosnje Hercegovinë, Kroaci, Mali i Zi

Zbatuar nga: Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe I2UD Instituti për Zhvillim Ndërkombëtar Urban

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në bashkëpunim me Institutin për Zhvillim Ndërkombëtar Urban (I2UD), janë duke zbatuar projektin e Qëndrueshmërisë Sociale dhe Angazhimit Qytetar (SSCE), nën Programin e Partneritetit Urban (UPP). Faza e dytë e këtij projekti bazohet në mësimet dhe praktikat më të mira që dolën gjatë fazës së parë të zbatimit të tij (2012-2013), duke përfshirë dhe zgjeruar më tepër fokusin mbi angazhimin qytetar. Qëllimi i projektit për fazën e II-të është të zgjerohej duke përfshinte të shtata vendet e rajonit, përkatësisht: Shqipërinë, Bosnje Hercegovinën, Kroacinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Kosovën dhe Serbinë, duke rritur numrin e përgjithshëm të qyteteve, ku do zhvillohet projekti në 9 në total. Aktivitetet në kuadër të këtij projekti do të zbatohen në sinergji me komponentët e tjerë të UPP II, respektivisht me Iniciativën e Ndërtimit të Integritetit, Vetëvlerësimit financiar Bashkiak dhe Auditit Urban. Zgjerimi i projektit të Auditimit të Qëndrueshmërisë Sociale në 9 qytete në rajonin e Ballkanit Perëndimor bëhet për të rritur njohuritë dhe ndërgjegjësimin mbi llogaridhënien sociale të aktorëve vendorë, ku përfshihet shoqëria civile, zyrtarët qeveritarë, banorët dhe grupet e marginalizuara urbane; dhe për të forcuar integritetin në ofrimin e shërbimeve publike, duke rritur kërkesën për qeverisje të mirë, llogaridhënie sociale dhe rritje të angazhimit qytetar, në një perspektivë rajonale.



Në arritjet për vitin 2015 përfshihet kuadri i përditësuar analitik dhe metodologjik, plani i punës për matjen e Llogaridhënies Sociale në qeverisjen vendore, dhe koordinim konceptual ndërmjet komponentëve të UPP-së, të gjitha këto përfshirë në Raportin Fillestar të projektit. Aktivitetet kryesore gjatë 2015 përfshijnë: [1] Workshop-in Teknik (Trajnimi i Trajnerëve / TOT), si ngjarja e parë rajonale e projektit, e cila shërbeu për nisjen e projektit, por dhe si një mundësi ku të gjithë aktorët e përfshirë nga i gjithë rajoni të takoheshin. Workshop-i funksionoi si një tryezë e rumbullakët për konsultime, diskutime, dhe rishikim në drejtim të metodologjisë së projektit, aktiviteteve dhe planit të punës. [2] Dialogu Kombëtar në Shqipëri- është një aktivitet që shërbeu për mbajtjen e një dialogu të strukturuar midis përfaqësuesve të qeverisë lokale dhe qendrore; për të nxitur përfshirjen e aktorëve të ndryshëm qeveritarë, departamenteve specifike (financa, planifikimi, teknika) dhe shoqërisë civile, në mënyrë që të integrohen komponentët e ndryshëm të UPP-së dhe të afrohen në nivel lokal; mbështetje të njëjësive të pushtetit vendor në procesin e inventarizimit dhe konsolidimit, si dhe mbështetje për ankorimin e instrumentave vetë-vlerësuese si pjesë e praktikës bashkiake. Për më tepër gjatë vitit 2015, u hap tenderi dhe u përzgjedhën bashkitë që do përfshiheshin në projekt. SSCE do të zbatohet në Shqipëri në Bashkinë e Elbasanit, ku një memorandum mirëkuptimi është nënshkruar me Kryetarin e Bashkisë.



Monitorimi sistematik i gjëndjes financiare dhe Praktika e menaxhimit financiar në nivel vendor

Periudha e Zbatimit: 2015

Donator: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)

Fondi: 17,100 USD

Zbatohet në: Shqipëri

Zbatuar nga: Co-PLAN, OSFA, Ministria e Financave dhe Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore në Shqipëri

Co-PLAN, në partneritet me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, dhe me mbështetjen e Ministrisë së Financave dhe Ministrit të Shtetit për çështjet Vendore, ndërmori këtë projekt duke hartuar, zhvilluar dhe ofruar një platformë dixhitale, e cila mundëson jo vetëm ndarjen e të dhënave financiare dhe fiskale të qeverive lokale, por edhe interpretimin e tyre. Kjo platformë shërbën si një risi që i ofron të dyja niveleve të qeverisjes për të marrë vendime të informuara mbi një bazë sistematike të të dhënave dhe treguesve krahasues. Qëllimi i platformës është përmirësimi i performancës së përgjithshme dhe gjëndjes financiare të qeverive vendore, për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe të shërbejë si një mjet për komunikim dhe dialog mes aktorëve të ndryshëm të përfshirë në çështjet e qeverisjes vendore. Platforma mundëson jo vetëm ndarjen e të dhënave financiare dhe fiskale të njësive të qeverisjes vendore për periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2014, por mundëson edhe një analizë krahasuese, siguron një mjet të fortë e të rëndësishëm për monitorimin e performancës financiare dhe fiskale të NJQV-ve, duke rritur në këtë mënyrë transparencën në qeverisje, dhe përmirësimin në vendimmarrje të informuar. Për më tepër, platforma ndihmon përfaqësues të qeverisë vendore dhe qendrore, OSHC-të, mediat, universitetet dhe institutet kërkimore, profesionistë të fushës, qytetarët, Shoqatat e Qeverisjes Vendore, si dhe aktorë të tjerë të interesuar për të aksesuar, kuptuar, monitoruar dhe përdorur të dhënat mbi performancën financiare të pushtetit vendor në Shqipëri.

Disa prej rezultateve të projektit për vitin 2015 mund të përmbliidhen si në vijim:

Ndërtimi i një portali dixhital të të dhënave financiare

Krijimi i një metodologjie për mbledhjen e të dhënave

Mbledhja sistematike e të dhënave (përmes Ministrisë së Financave)

Përgatitja dhe nxjerrja e treguesve për monitorimin e gjëndjes dhe performancës financiare

Përgatitja e raporteve mbi tregues të ndryshëm dhe njësi të ndryshme të qeverisjes vendore

Ndarja e informacionit dhe përfshirja e palëve të ndryshme (OSHC, media, universitetet / institutet kërkimore, qytetarët, NJQV, profesionistë, donatorët, bankat)

Mirëmbajtja dhe përditësimi i platformës

Një brez sistematik i raporteve dhe treguesve (prill - maj)

Një kuptim më të mirë dhe më koherente të çështjeve të qeverisjes vendore në Shqipëri;

Sigurimi i një platforme të dialogut ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë dhe të interesuar në çështjet e qeverisjes vendore.

Platforma dixhitale për financat lokale mund të aksesohet në: www.financatvendore.al



Zhvillimi dhe Përshtatja e Programeve Profesionale mbi Efiçencën e Energjisë në Ballkanin Perëndimor

Periudha e Zbatimit: 2013 – 2016

Donatori: Bashkimi Evropian (TEMPUS)

Fondi: 825, 101 Euro

Zbatuar në: Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi

Zbatuar nga: 11 partnerë (të specifikuar më poshtë)

“Zhvillimi dhe përshtatja e programeve profesionale mbi efiçencën e energjisë në Ballkanin Perëndimor” është një project TEMPUS për Europën Jug-Lindore, zyrtarisht i lançuar në Janar të 2014 duke prekur për herë të parë Shqipërinë, pasi është projekti i parë TEMPUS, i cila ka si partner kryesor një institucion shqipëtar, specifikisht Universitetin POLIS. Qëllimi i këtij projekti është të kontribuojë në modernizimin e arsimit në Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi dhe për të përmbushur nevojat e tregut duke zhvilluar programet profesionale me fokus në efiçencën energjitike. Këto programe do të zhvillohen si kurse mësimore gjatë ciklit dy-vjeçar pasuniversitar dhe në nivelet profesionale Master, në 5 institucione në Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi. Projekti, gjithashtu ka për qëllim që të krijojë qëndrueshmëri mes partnerëve të vendeve specifike në sektorin e arsimit dhe të biznesit, për punësim të studentëve si dhe të japë rekomandime për integrimin e programeve profesionale brenda sistemit arsimor të secilit vend partner deri në vitin 2016. Në një objektiv më të përgjithshëm, ky projekt ka për qëllim të adresojë mungesën e programeve profesionale arsimore në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi në fushën e efiçencës energjitike. Për këtë arsye, produktet përfundimtare dhe aktivitetet janë drejtuar kryesisht drejt përmbushjes së këtij objekti. Projekti nxit programe profesionale arsimore në fushën e efiçencës energjitike, që do të ndryshojnë sipas konteksteve kombëtare dhe institucioneve arsimore përkatëse për secilin shtet. Këto programe janë një përgjigje ndaj kërkesës së qeverisë, industrisë dhe studentëve për aftësi më të aplikuara, si në diplomat dy-vjeçare të nivelit pasuniversitar ashtu edhe në diplomat profesionale të nivelit Master. Projekti sjell së bashku ekspertizën dhe përvojën për zhvillimin e kurrikulave dhe për zbatimin praktik të parimeve të efiçencës energjitike. Programet e studimit përmbajnë disa lëndë

tematike, duke përfshirë, njohuritë teknike, aftësitë e aplikuara, rregulloret evropiane në fushën e efijencës energjitike, praktikë pune (internship) dhe një projekt përfundimtar. Programet profesionale në Master do ti pajisin studentët, që zotërojnë njohuri të mjaftueshme teorike, me aftësitë aq të nevojitura të fushës teknike dhe asaj të aplikuar, duke rritur ndjeshëm kështu mundësitë për punësim. Projekti ka gjithësej 11 partnerë, Universitetin POLIS (Shqipëri) në cilësinë e partnerit drejtues, Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës (Shqipëri), Universitetin e Prishtinës (Kosovë), Universitetin për Biznes dhe Teknologji (Kosovë), Universitetin e Malit të Zi (Mali i Zi), Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (Shqipëri), Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit (Shqipëri), Universiteti i Minho (Portugali), Universiteti i Shkencave të Aplikuara Van Hall Larenstein (Hollandë), Anhalt Universiteti i Shkencave të Aplikuara (Gjermani), Universiteti Sllovak i Teknologjisë në Bratislavë. (Sllovaki).

Për vitin 2015 disa nga aktivitetet dhe rezultatet kryesore përfshijnë:

- Një numër i kurrikulave mësimore për efijencën energjiike tashmë janë bërë pjesë e programit akademik në Universitetin POLIS , dhe në Universitetin për Biznes dhe Teknologji.
- U ndërtua laborator i Efijencës së Energjisë në Universitetin POLIS.
- Aktivitete kombëtare mbi efijencën energjitike u organizua në Tiranë.
- Për partnerët e projektit u organizua një udhëtim studimor në Gjermani, fokusuar në çështje të efijencës energjitike;
- Në Mal të Zi dhe Kosovë, u organizuan 2 takime kombëtare mbi çështje e efijencës energjitike;
- U përgatitën dhe u publikuan 3 publikime, të cilat mbulojnë çështje të efijencës energjitike;
- Pjesëmarrje në programe të shumta televizive, si: Televizioni Kombëtar Shqiptar, Top Channel, për të adresuar çështje lidhur me efijencën energjitike.





TraSaCu (Traffic Safety Culture)

Kultura e Sigurisë Rrugore dhe Qasja ndaj Sistemeve të Sigurisë - Drejt një hulumtimi mbi ndryshimet kulturore dhe Agjenda e Inovacionit mbi Sigurinë Rrugore

Periudha e zbatimit: Janar 2015 - Dhjetor 2017

Donator: Bashkimi Evropian, nëpërmjet Horizon 2020 Program, Grant i Marie Skłodowska-Curie

Fondi: xx

Zbatuar në: Vjenë (Austri), Athinë (Greqi), Talin (Estoni), Tiranë (Shqipëri), Ankara (Turqi), Helsinki (Finlandë), Prishtinë (Kosovë), Hagë (Holandë), Blacksburg (Virginia, SHBA), Bozeman (Montana, USA)

Zbatuar nga: KfV-së - Bordi Austriak i sigurisë rrugore; Instituti Rrugor i Sigurisë "Panos Mylonas" (Greqi), University i Teknologjisë Talin (Estoni), Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit (Shqipëri), METU - Universiteti Teknik i Lindjes së Mesme (Turqi), Qendra kërkimore mbi Trafikun (Finlandë), Universiteti Polis (Shqipëri), AMRKS - Shoqata e Motorizimit të Kosovës, SWOV - Instituti Kërkimor për Sigurinë Rrugore (Holland), TCN - Telekomunikacioni dhe Rrjetat kompjuterike (Shqipëri), TU Vienna - Universiteti Teknik i Vjenës, Instituti Politeknik i Virginias dhe Universiti Shtetëror (SHBA), MSU - Universiti Shtetëror i Montanës Bozeman (SHBA).

TraSaCu është një projekt i financuar nga BE-ja me qëllim ekspozimin e sfondit kulturor dhe atyre modeleve të sjelljes në rrugë që ndikojnë në sigurinë rrugore dhe në probleme të përgjithshme të trafikut në qytetet e sotme moderne. Co-PLAN dhe Universiteti Polis, së bashku me 11 institucione të tjera akademike dhe kërkimore nga 9 vende të botës, kanë marrë pjesë në këtë projekt nëpërmjet këmbimit të frytshëm të përvojave të stafit. Duke qënë se kultura e sigurisë është identifikuar si një nga faktorët kryesorë që ndikon në sigurinë rrugore, projekti TraSaCu ka realizuar përgjatë 2015 arritjet e mëposhtme:

- Krijimin e një platforme të njohurive publike dhe ndërtimin e një mjedisi institucional për hulumtime, për të lehtësuar shkëmbimin e



informacionit midis vendeve pjesëmarrëse dhe të tjerë (platforma ka përfunduar në vitin 2015, dhe përditësohet përgjatë çdo viti)

- Kryerjen e analizave metodologjike dhe krahasimore bazuar në treguesit e ndryshëm kulturor mbi sigurinë rrugore (përfunduar në 2015)

- Kuptimi i lidhjes ndërmjet qëndrimeve dhe sjelljeve që ndikon në sigurinë rrugore për të gjitha vendet pjesëmarrëse (proçes i vazhdueshëm përgjatë gjithë zhvillimit të projektit) (planifikuar të përfundoj në fund të këtij viti).



Në këtë kuadër, Co-PLAN ka bashkëpunuar ngushtë me METU - Universitetin Teknik të Lindjes së Mesme dhe TU_Vienna - Universitetin Teknik të Vjenës, ku 2 anëtarë të stafit kanë punuar në zyrat e tyre për një periudhë prej 3 muajsh në mbledhjen e të dhënave dhe analizave për kontekstin shqiptar. Për më tepër, Co-PLAN ka mikëpritur 2 anëtarë të stafit nga KfV, Bordi Austriak për Sigurinë Rrugore. Kjo përvojë ka ndihmuar në hedhjen e bazave për një studim të thelluar të kulturës aktuale të trafikut në Shqipëri, ku me ndihmën e studentëve të Polis janë kryer vëzhgime anësore të ndryshme të sjelljes së shoferëve dhe këmbësorëve në rrugë, në pikat e nxehta të trafikut në Tiranë. Përveç kësaj, janë zhvilluar intervista të ndryshme me ekspertë lokalë, për të marrë një pamje më të plotë mbi çështjet administrative të sigurisë rrugore në Shqipëri. Kontributi i Co-PLAN në TraSaCu do të finalizohet me anë të një raporti kombëtar mbi situatën e përgjithshme të sigurisë rrugore në Shqipëri, si dhe një kapitulli të veçantë mbi shkeljet e trafikut në një raport të unifikuar, me të dhëna të kombinuara nga të gjitha vendet partnere në projekt.





Hartimi i Planeve Operative të Zhvillimit Lokal (POZHL) për Njësitë e sapoformuara të Qeverisjes Vendore në Shqipëri

Periudha e Zbatimit: Dhjetor 2015- 31 Janar 2016

Donatori: UNDP

Fondi: 4,288,840 ALL

Zbatuar në: Bashkitë e Gramshit, Belshit dhe Peqinit

Zbatuar nga: Co-PLAN dhe Universiteti POLIS

Hartimi i Planeve Operative të Zhvillimit Lokal (POZHL) për Njësitë e sapoformuara të Qeverisjes Vendore (NJQV) të Gramshit, Belshit dhe Peqinit, vjen si një përgjigje ndaj sfidave të shumta dhe nevojave të bashkive të reja për integrimin e planeve të ndryshme të veprimit dhe për të siguruar kohezionin administrativ dhe territorial të një territori të zgjeruar tashmë. NJQV-të e ndryshme kanë sot planet e tyre të zhvillimit vendor, shpesh të hartuara me ndihmë ndërkombëtare ose nëpërmjet ekspertizës vendore. Edhe pse përdorimi i këtyre planeve për investime apo qëllime buxhetore ndryshon në masë të madhe nga njëra NJQV te tjetra, për arsye të ndryshme, që varrojnë nga mangësitë e modeleve të qëndrueshme, mungesa e kapaciteteve, burimeve ose formalizimit, për disa NJQV këto dokumente paraqesin një referencë të caktuar për qëllime të planifikimit apo aplikimit për projekte të ndryshme.

Detyrat kryesore në kuadër të këtij projekti janë:


Prezantimi i Idesë, përshkrimi i projektit dhe organizimit në bashkitë përkatëse.

Mbledhja e të gjitha dokumenteve ekzistuese strategjike të planifikimit dhe të dhënave në lidhje me bashkitë e reja.

Shqyrtimi, analiza dhe diagnoza e informacionit të mbledhur, përgatitja e drafteve të para të POZHL-së.

Shqyrtimi i drafteve, duke reflektuar ndërhyrjet qytetare dhe përgatitja e versionit zyrtar të POZHL-së.

Aktivitetet kryesore dhe rezultatet për vitin 2015: Fillimisht, grupi i punës ka filluar mbledhjen e informacionit bazë për komunitetet e Gramshit, Belshit dhe Peqinit. Pas humultimit të të dhënave elektronike, krijimit të një inventari të të dhënave dhe njohjes së përgjithshme të profilit të bashkive, grupi i punës ndër morri edhe vizitat e para në terren. Gjatë vizitave të para në të treja bashkitë, grupi u takua me zyrtarë dhe kryetarët e bashkive për të diskutuar prioritetet e tyre në lidhje me zhvillimin e territorit. Për të përfutur një gamë të gjerë pikëpamjesh mbi strategjitë e zhvillimit, rreth 20 intervista gjysmë të strukturuar / bashki janë realizuar me banorët dhe grupet e ndryshme të interesit. Faza e dytë e projektit korrespondon me hartimin e raportit të POZHL-së për secilën bashki, ku u identifikuan problemet dhe prioritetet duke përdorur analizën S.W.O.T. Pas kësaj, u zhvillua një forum lokal, ku u ndanë rezultatet e analizave. Rreth 40 njerëz morën pjesë në secilin takim, ku u identifikuan dhe u diskutuan projekte konkrete për zhvillimin e përgjithshëm të bashkive të reja. Në fund, u zhvilluan forumet e dyta, ku u prezantuan POZHL-të në versionet përfundimtare, duke reflektuar dhe pranuar ndërhyrjet nga qytetarët dhe bashkitë. Hapi i fundit përfshin miratimin zyrtar të POZHL-së nga këshillat bashkiakë.



Komponenti i Mbetjeve Urbane: Zhvillimi i skemave ndërvendore dhe modeleve të kompostimit në zonën e Pukës

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal

Periudha e Zbatimit: 2014 – 2015

Donatori: Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (dldp)

Fondi: 21,777 Euro

Zbatuar në: Zonën e Pukës

Zbatuar nga: Co-PLAN & Metro_POLIS shpk, Studio Arkitekture dhe Planifikimi

Zhvillimi i skemave ndërvendore dhe modeleve të kompostimit bazuar në praktika, në zonën e Pukës synon të përmirësojë shërbimin e manaxhimit të mbetjeve në zonën e Pukës në përputhje me politikat dhe legjislacionin kombëtar. Në terma dhe objektiva më specifike projekti synon të: (1) Ndërtojë dy skema të integruara dhe efektive për mbledhjen dhe grumbullimin e mbetjeve, ku qytetarët (përfshi këtu dhe grupet e ndjeshme) rrisin mbulimin e mbledhjes së mbetjeve me një minimum prej 20%; përgatitja dhe shpërndarja e metodologjisë dhe hapat për krijimin e një bashkëpunimi ndërvendor edhe të konsultuar me anëtarët e Qendrës së Kompetencës; (2) Përmirësimi i kapaciteteve financiare për manaxhimin e mbetjeve; (3) Mbështetja e iniciativave të kompostimit të komunitetit pilot, promovuar për tu përsëritur dhe në zona të tjera të Pukës, apo në nivel më të gjerë; (4) Aplikimi i standardeve të propozuara të mbetjeve dhe procedurave të standardizimit. Disa nga rezultatet e pritshme të këtij projekti janë: - Sigurimi i një marrëveshje ndërvendore për ofrimin e shërbimit dhe manaxhimit të mbetjeve të ngurta; Raport vlerësimi mbi gjendjen e vendgrumbullimit të mbetjeve (Pukë dhe FushëArrëz) duke përfshirë një plan të përgjithshëm të përmirësimit të vendgrumbullimit në Pukë; Zhvillimi i një sistemi faturimi dhe grumbullimi të tarifës në linjë me modelin e propozuar Kosto&Tarifë duke përfshirë një strategji si mund të faturohet dhe të komunikohen tarifat tek qytetarët, për të përforcuar grumbullimin e tyre; Modeli pilot i adaptuar për standardet dhe standardizimin, i përfshirë në kontratat e ofrimit të shërbimit; Hartimi i materialeve trajnuese për të drejtuar një fushatë të suksesshme dhe efektive për ndërgjegjësimin (prezantime) dhe skemave pilot të kompostimit (prezantime, video, etj.), duke përfshirë metodologjitë e thjeshta për vendosjen dhe zbatimin e skemave të kompostimit në komunitet, përfshirë dhe kostot përkatëse.

Zhvillimi i skemave ndërvendore në zonën e Malësisë së Madhe

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal

Periudha e Zbatimit: 2014 - 2015

Donatori: Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim – (dldp)

Fondi: 16,404 Euro

Zbatuar në: Malësinë e Madhe

Zbatuar nga: Co-PLAN & Metro_POLIS shpk, Studio Arkitekture dhe Planifikimi

Zhvillimi i skemave ndërvendore bazuar në praktika, në zonën e Malësisë së Madhe synon përmirësimin e sistemit të manaxhimit të mbetjeve në zonën e Malësisë së Madhe në linjë me politikat dhe legjislacionin kombëtar. Projekti është dizenuar për tu zbatuar në një periudhë 1-vjeçare, që nënkupton përmbushjen e rezultateve të pritshme brenda kohëzgjatjes së dhënë. Në terma më specifikë projekti synon të: (1) Të ndërtojë një skemë të integruar dhe efektive të mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve, ku qytetarët rrisin mbulimin e mbledhjes së mbetjeve me një minimum prej 20%; të vlerësojë kushtet për largimin e mbetjeve dhe të parashikojë masat përmirësuese; të përgatitë dhe të shpërndajë me anëtarët e qendrës së kompetencave metodologjinë dhe hapat për krijimin dhe funksionimin e bashkëpunimit ndërvendor; (2) Aplikimi i standardeve të propozuara të mbetjeve dhe procedurave të standardizimit. Disa nga rezultatet e pritshme të këtij projekti janë:

- Një marrëveshje ndërvendore për ofrimin e shërbimit dhe manaxhimit të mbetjeve të ngurta.
- Zhvillimi i një sistemi faturimi dhe grumbullimi të tarifës në linjë me modelin e propozuar Cost&Tariff, duke përfshirë një strategji për faturimin dhe komunikimin e tarifave të qytetarët, për të përforcuar grumbullimin e tyre.
- Hartimi i materialeve trajnuese për të drejtuar një fushatë të suksesshme dhe efektive për ndërgjegjësimin.
- Modeli pilot i adaptuar për standardet dhe standardizimin, i përfshirë në kontratat e ofrimit të shërbimit.
- Një udhëzues për organizimin e bashkëpunimit ndërvendor në sektorin e manaxhimit të mbetjeve.
- Një raport paraprak për "Vlerësimin e ndikimit në mjedis" për vendgrumbullimin e mbetjeve në Koplik.
- Një plan rehabilitimi, i cili përfshin dhe kostot relevante.



